

Neuchâtel, 3 prill 2023

Asambleja Popullore e Corcelles-Cormondrèche

Zonjë, Zotëri,

Si pjesë e marrëveshjes së bashkimit midis komunave të Corcelles-Cormondrèche-s, Neuchâtel-it, Peseux-së dhe Valangin-ës, krijimi i asambleve popullore po merr formë që në gjysmën e parë të vitit 2023. Për komunën e re të Neuchâtel-it, kjo ka të bëjë me vendosjen e një sistemi të demokracisë lokale që i përmbush më së miri pritshmëritë e banorëve. Kushdo që banon në territorin e komunës mund të marrë pjesë në debatet qytetare të kuvendit të zonës së tij.

Për këtë arsye, ju ftojmë në seancën konstituive të Asamblesë Popullore të lokalitetit Corcelles-Cormondrèche, **ditën e martë më 2 maj, ora 19:30, në sallën e shfaqjeve, rue de la Croix 4, në Corcelles.**

Me këtë rast, qëllimet dhe parimet themelore të qeverisjes së asambleve popullore, si dhe mjetet dhe instrumentet demokratike në dispozicion të pjesëmarrësve do t'ju parashtrihen përpara se të caktohet zyra, nëpërmjet shortit (me të drejtë refuzimi) midis të pranishmëve.

Raportin e komisionit të asambleve popullore për Këshillin e Përgjithshëm, së bashku me atë të lagjeve, si dhe rregulloret që kanë të bëjnë me kuvendet popullore, të 14 nëntorit 2022, mund ta gjeni në faqen internet të qytetit të Neuchâtel-it, në adresën: www.neuchatelville.ch/assembleescitoyennes

Për çdo pyetje shtesë, ju mund të kontaktoni Shërbimin e Popullsisë dhe të Lagjeve nëpërmjet sportelit të pritjes së Corcelles-Cormondrèche (rue de la Croix 7, tel 032 886 53 00 e-mail accueil.corcelles-cormondreche@ne.ch).

Duke shpresuar se kjo ftesë për të marrë pjesë në një mekanizëm të ri të demokracisë lokale do të tërheqë vëmendjen tuaj, ju lutemi të pranoni, Zonjë, Zotëri, respektin dhe përshëndetjet tona më të mira.

Këshilli komunal